



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-KËSHILLI DREJTUES-

Nr. _____ prot.

Tirane me, ____ . ____ .2010

V E N D I M
Nr.1170, datë 19.02.2010

Per

“Miratimin e projekt-rregullores per: “Pagesat per mbikqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike

Këshilli Drejtues (KD) te Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | |
|---------------------------|---------|
| 1. Z. Piro Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira Nurçe | Anëtar |

dhe Znj. Marsida Drushku-Sekretar i KD, në mbledhjen e datës 19.02.2010, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, mori në shqyrtim dokumentin e pergatitur nga Grupi i Punes: “Per pagesat per mbikqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike.

BAZA LIGJORE:

- Ligji nr. 9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 24, neni 135 - 138.
- Neni 1 i ligjit nr. 7697, datë 7.4.1993 “Për kundravajtjet administrative”,
- (i ndryshuar).
- Rregullore e Brendshme, miratuar me Vendim te Këshillit Drejtues nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim nr.452, datë 02.05.2008, neni 21, pika 1,17,28.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

VËREHET SE,

Me Urdher Nr.2378, date 16.09.2008, është ngritur Grupi i Punës për përgatitjen e dokumentit rregullator për “Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike”, bazuar në nenin 24 të ligjit Nr. 9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Grupi i Punës me qëllim ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrimeve të AKEP, të përcaktuara në ligj, ka përgatitur dokumentin rregullator për “Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” dhe e ka paraqitur për miratim për konsultim publik në Këshillin Drejtues të AKEP.

Me vendim nr.518, date 11.12.2008 Këshilli Drejtues, ka vendosur publikimin e këtij dokumenti për konsultim publik në faqen zyrtare të AKEP, në mënyrë që sipërmarresit e interesuar të paraqesin me shkrim mendimet dhe propozimet e tyre për aktin. Në përfundim të procesit të konsultimit publik për dokumentin rregullator “Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike”, kanë paraqitur komentet e tyre palët e interesuara:

- Vodafone Albania Sh.a.;
- Albanian Mobile Communications (AMC) Sh.a.;

të cilat janë bërë pjesë e praktikës dokumentare të paraqitur nga grupi i punës për miratim. Grupi i punës, mbi komentet e palëve të interesuara për dokumentin rregullator gjatë procesit të konsultimit publik ka parashtruar qëndrimin e tij të arsyetuar duke paraqitur dokumentin për miratim.

Konkluzionet e grupit të punës janë pasqyruar në variantin përfundimtar të dokumentit rregullator “Për Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.

A T E H E R E:

Këshilli Drejtues i AKEP, duke çmuar se:

1. Dokumentacioni i paraqitur me shkresën nr. ____ prot., datë _____.____.2010 nga grupi i punës, për miratimin e dokumentit rregullator “Rregullore mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” nga pikpamja formale është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 10/1 të Rregullores së Brendshme të AKEP.
2. Procedura e konsultimit publik për dokumentin rregullator “Rregullore mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” është kryer në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 110 të ligjit nr. 9918.
3. Qëndrimi i parashtruar nga grupi i punës mbi komentet e paraqitura nga palët e interesuara gjatë procesit të këshillimit publik për dokumentin rregullator është i drejte, i rregullt dhe në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 9918.
4. Varianti përfundimtar i dokumentit rregullator “Rregullore mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” reflekton konkluzionet e grupit të punës bazuar në qëndrimin e mbajtur mbi komentet e bëra nga palët e interesuara gjatë procesit të konsultimit publik dhe përmbush qëllimet e AKEP-it për realizimin e objektivave rregullatore sipas nenit 7 të ligjit nr. 9918.

P E R F U N D I M I S H T:

Për sa më sipër dhe duke patur parasysh se dokumenti “Rregullore mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe me ndikim të vecantë në veprimtarinë e AKEP, Keshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Rregullore mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” të paraqitur nga grupi i punës, me përmbajtjen sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kjo rregullore të publikohet në faqen e internetit të AKEP. www.akep.gov.al
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

A N E T A R E :

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

R R E G U L L O R E

MBI
“PAGESAT PER MBIKEQYRJEN
E TREGUT TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”

“Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, Nr.1170, datë19/02/2010

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike që duhet të kryejnë sipërmarrësit, brenda kufirit prej 0,5 % të së ardhurës vjetore, në përputhje me ligjin nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i rregullores është që me anë të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut, sipas nivelit të llogaritur mbi bazën e kësaj rregulloreje, si dhe pagesat e tjera që kryhen sipas neneve 78 dhe 86 të ligjit nr. 9918, të garantohet financimi i nevojshëm për mbulimin e fondit të shpenzimeve administrative të AKEP, në përputhje me nenin 117 të këtij ligji.

Neni 3 Baza Ligjore

Neni 24, pikat 1 dhe 2 të nenit 117, pika 1.a) e nenit 119, të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji 9918).

Neni 4 Fusha e veprimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim nga gjithë sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, të cilët janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike për AKEP-in.

Neni 5 Llogaritja e pagesës

Pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike është pagesë e plotë vjetore dhe llogaritet mbi të ardhurat nga ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike të paraqitura në bilancin vjetor të sipërmarrjes. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe /ose shërbime publike të komunikimeve elektronike dhe kanë aktivitete të tjera në bilancin vjetor, duhet që të ardhurat nga ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike të pasqyrohen të ndara nga të ardhurat e tjera.

Neni 6 Depozitimi i bilancit

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete/shërbime publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të paraqesin në AKEP bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, kopje të

Formularit te Deklarimit dhe Pageses se Tatimit mbi Fitimin një kopje të raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për shoqëritë që e kanë të detyruar ekspertizën sipas legjislacionit në fuqi, te depozituara në Drejtorinë Rajonale te Tatimeve brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

Neni 7

Llogaritja e nivelit të pagesës vjetore

AKEP, deri më datë 15 Prill të çdo viti bën llogaritjen e nivelit të pagesës vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike të sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike. Niveli i pagesës vjetore për mbikqyrje të tregut të komunikimeve elektronike përcaktohet në përqindje, është i barabartë për sipërmarrësit dhe miratohet nga Këshilli Drejtues. Niveli i pagesës vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike do të jetë brenda kufirit prej 0.5% të së ardhurës vjetore të sipërmarrësve, dhe llogaritet me formulën:

$$NPV = \frac{KAdV}{AV} \times 100$$

- NPV - Niveli i pagesës vjetore të mbikqyrjes të tregut të komunikimeve elektronike (në%)
- KAdV - Kosto administrative vjetore e AKEP, që do të financohet nga pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.
- AV - Shuma e të ardhurave vjetore të sipërmarrjeve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike për komunikime elektronike të paraqitura në bilancin vjetor.

Neni 8

Llogaritja e pagesës për sipërmarrësit

Deri më datë 20 Prill të çdo viti, AKEP bën llogaritjet dhe faturimin e pagesës për çdo sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare. Pagesa vjetore që bën sipërmarrësi llogaritet sipas formulës:

$$PV = AV \times NPV$$

- PV - Pagesa vjetore e sipërmarrësit për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike
- AV - Të ardhurat vjetore të sipërmarrjes sipas bilancit vjetor.
- NPV - Niveli i pagesës vjetore i miratuar nga Këshilli Drejtues në përqindje.

Neni 9

Faturimi dhe Pagesa

Jo më vonë se data 22 Prill të çdo viti AKEP duhet t'u dergoj sipërmarrësve faturën e pagesës për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe jo më vonë se data 30 Prill

të çdo viti sipermarrësit duhet të bëjnë pagesën. Pagesa do të bëhet në llogaritë e AKEP-it të specifikuara në faturën që i dërgohet sipermarrësit.

Neni 10

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e rregullores

Strukturat përgjegjëse në AKEP për zbatimin e kësaj rregulloreje janë Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtoria e Licensimit.

Strukturat përgjegjëse, sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në këtë rregullore raportojnë rregullisht tek Kryetari dhe Këshilli Drejtues, mbi ecurinë e zbatimit të procesit për llogaritjen dhe vjeljen e pagesave për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 11

Kundërvajtjet administrative

Mosdorëzimi në AKEP i bilancit vjetor dhe raportit të ekspertit kontabël nga sipermarrësit, brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore, si dhe mospagesa e plotë e shumës për mbikëqyrjen e tregut nga ana e sipermarrësit, sipas faturës së dërguar nga AKEP- i në përputhje me këtë rregullore, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe janë të dënueshme sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9918 për këtë qëllim.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues.